



Prishtinë: 30.10.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1068_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1861_09_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **19.10.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 30.10.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit N. V. nga Prishtina me shifër të konsumatorit: DPR – 76101 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1861_09_18** i datës 17.09.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 24.08.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se parashtron ankesë për shkak të fakteve të gabuara të shkeljes të së drejtës procedurale, të shkeljes të së drejtës ligjore dhe të shkeljes të së drejtës materiale. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se nga muaji shtator 2010 e deri më qershor 2011 është mbingarkuar energji elektrike deri më 543 €, dhe se ZRRE ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori ka theksuar se ai ka harxhime të një familje mesatare me disa drita elektrike dhe ndonjë TV aparatet, makina larëse dhe nxehtësi të ujit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se vendimi i organi të shkalës së parë përmban shkelje të së drejtës procedurale, shkelje të së drejtës ligjore, si dhe shkelje të së drejtës materiale, Bordi i ZRRE thekson se konsumatori me asnjë provë nuk ka argumentuar se ku vendimi i organi të shkalës së parë ka shkelje, kur dihet se vendimi i organit të shkalës së parë është bazuar mbi bazën ligjore të marrjes së vendimit, dhe është bazuar në prova konkrete.



Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës, duke filluar nga vërtetimi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 006556 i datës 15.02.2010, procesverballi mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0602898 i datës 14.12.2015, procesverballin e qendrës së kalibrimit të punuar me datë 18.03.2010 si dhe protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik Nr. org. 02 nr. 1428 datë 27.01.2016 dhe ka konstatuar se protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik të datës 18.03.2010, dhe ka vërejtur se është bërë shqyrtimi i njehsorit elektrik nr. 21061963 nuk është vërejtur asnjë parregullsi si dhe është konstatuar se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar matës. Gjithashtu Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik të datës 27.01.2016 dhe ka vërejtur se bërë shqyrtimi i njehsorit elektrik nr.08196079 nuk është vërejtur asnjë parregullsi si dhe është konstatuar se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar matës.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se nga muaji shtator 2010 e deri më qershor 2011 është mbingarkuar energji elektrike, Bordi i ZRRE thekson se kjo nuk qëndron pasi që gjatë analizës së bërë të gjithë shkresave të lëndës nuk është vërejtur se për këtë periudhë konsumatori ka lexim dhe faturim jo të saktë (mbingarkim), përveç periudhës së lartcekur. Bordi i ZRRE-së thekson se lexim dhe faturim jo të saktë është vetëm në periudhën 01/2011 dhe 02/2011 dhe se për konstaton se korrigjimi i bërë nga KESCO për periudhën 01/2011 dhe 02/2011 në vlerë -58.73€ është i saktë dhe se nuk ka elemente tjera të korrigjimit që duhet bërë konsumatorit. Bordi i ZRRE thekson se bazuar në transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstaton se KEDS/KESCO ka respektuar nenin 28 paragrafin 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: 3. *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit N.V.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.